



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE
Kryetari**

*Dolet te
te ngritjen e nēnkomisionit
për vlerësimin kalimtar dhe periodik
të punonjësve të Policisë së
Shtetit, Gardës së Republikës dhe
Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe
Ankesat në Ministrinë e Brendshme*

Nr. 2299 Prot.

Tiranë, më 10.07.2018

Lënda : Për ngritjen e nënkomisionit parlamentar që do ndjekjë dhe mbikëqyrë zbatimin e ligjit nr.12/2018, “Për Vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”

Drejtuar: Z.Gramoz RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË ✓

Për dijeni: Z.Taulat BALLA
Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

Tiranë

I nderuar z.Kryetar i Kuvendit,

I nderuar z.Balla,

Kuvendi i Shqipërisë më datë 5.3.2018, ka miratuar ligjin nr. 12/2018, “Për Vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, ligji është shpallur në fletoren zyrtare, me Dekretin Presidentit të Republikës, Nr. 10747, datë 20.3.2018, si dhe ka hyrë në fuqi më datë 4.4.2018.

Në nenin 67 të ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, parashikohet ngritja një nënkomisioni parlamentar, në përbërje të Komisionit të përhershëm të Kuvendit “Për Sigurinë Kombëtare”.

Objekti dhe fusha e veprimtarisë së nënkomisionit do jenë; ndjekja dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit, nr. 12/2018, “Për Vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”

së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”. Nënkomisioni do organizohet dhe funksionojë sipas parashikimeve ligjore për nënkomisionet, në përbërje të Komisionit të përhershëm të Kuvendit “Për Sigurinë Kombëtare”.

Nga sa më lart, Ju vëmë në dijeni se Kuvendi i Shqipërisë, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Brendshme”, ka detyrimin ligjor të fillojë procedurat parlamentare për ngritjen e nënkomisionit parlamentar për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligji, nr. 12/2018, “Për Vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”.

Procedura ligjore për ngritjen e nënkomisioneve:

Përbërja, kompetencat, mënyra e organizimit dhe funksionimit e komisioneve të përhershme dhe nënkomisionve të Kuvendit, rregullohen nga nenet 18, 19, 20, 21, të Rregullores së Kuvendit:

¹Në përbërje të komisioneve të përhershme, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, mund të ngrihen edhe nënkomisione për probleme të veçanta.

²Anëtarët e nënkomisioneve, së bashku me kryesitë e tyre, zgjidhen me votim të hapur nga Kuvendi me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, duke u mbështetur në listat e kandidatëve të hartuara në marrëveshjen e Kryetarit të Kuvendit me kryetarin e çdo grupi parlamentar.

³Kuvendi mund të ndryshojë përbërjen e nënkomisioneve, duke ruajtur përpjesëtimin që zënë grupet parlamentare në Kuvend. Për ndryshimin e numrit dhe të përbërjes së nënkomisioneve synohet arritja e mirëkuptimit mes grupeve parlamentare.

Duke Ju falënderuar për vëmendjen,

Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare

Ermonela (Felaj) VALIKAJ

¹ Neni 19, pika 2 e Rregullores së Kuvendi

² Neni 21, pika 1 e Rregullores së Kuvendi

³ Neni 21, pika 2 e Rregullores së Kuvendi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKT - VENDIM

PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT PARLAMENTAR “PËR NDJEKJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT NR 12/2018 PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PËRIODIK TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS, DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT”, NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË KUVENDIT PËR SIGURINË KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 67, të ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, të neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Ngrihet Nënkomisioni parlamentar “Për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligji, nr. 12/2018, “Për Vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”.

II. Nënkomisioni organizohet dhe funksionon sipas parashikimeve ligjore për nënkomisionet, në përbërje të Komisionit të përhershëm të Kuvendit për Sigurinë Kombëtare.

III. Fusha e përgjegjësisë së këtij Nënkomisioni janë; ndjekja dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit, nr. 12/2018, “Për Vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 7 anëtarë si më poshtë:

- | | |
|--------------------|------|
| 1. Kryetar | (PS) |
| 2. Zëvendëskryetar | (PD) |
| 3. Anëtar | (PS) |
| 4. Anëtar | (PS) |

- | | |
|-----------|-------|
| 5. Anëtar | (PS) |
| 6. Anëtar | (LSI) |
| 7. Anëtar | (PD) |

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI